



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport individual i konsultimit publik

për projektvendimin:

“Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte, si dhe formularin e autorizimit”.

1. Titulli i projekt vendimit

“Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte, si dhe formularin e autorizimit”.

Ky projektvendim përcakton kuadrin rregullator për eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme, mbetjeve inerte dhe mbetjeve të rrezikshme, si dhe për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe inerte, duke përfshirë edhe formularin përkatës të autorizimit. Në këtë projektvendim përcaktohen procedurat administrative dhe regjimin e kontrollit për dërgesat e mbetjeve, në varësi të origjinës, destinacionit dhe itinerarit të transportit, llojit të mbetjeve, si dhe mënyrës së trajtimit të tyre në destinacionin përfundimtar.

Në këtë kuadër, projektvendimi synon të sigurojë që çdo dërgesë mbetjesh të kryhet në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat ligjore në fuqi, duke garantuar trajtim të sigurt dhe të qëndrueshëm gjatë gjithë ciklit të transportit dhe përpunimit të tyre.

Objekt i këtij vendimi janë të gjitha kategoritë e mbetjeve që rregullohen nga ligji nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, duke përfshirë si mbetjet e rrezikshme ashtu edhe ato jo të rrezikshme, në përputhje me klasifikimet dhe përkufizimet përkatëse ligjore. Projektvendimi përcakton në mënyrë të detajuar procedurat administrative dhe mekanizmat e kontrollit për dërgesat e mbetjeve, të cilat diferencohen në varësi të origjinës, destinacionit dhe itinerarit të transportit,

natyrës dhe llojit të mbetjeve, si dhe llojit të operacionit të trajtimit që do t'u nënshtrohen në vendin e destinacionit, duke siguruar një qasje të integruar dhe të kontrolluar në menaxhimin ndërkufitar të tyre.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektvendimi Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte, si dhe formularin e autorizimit” iu nënshtroa procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP), nga data 29.4.2026 deri në datë 29.5.2026. Ka patur në total 288 shikime dhe 0 komente të regjistruara në RENJKP.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e konsultimit, e përdorur për këtë projektvendim, ishte:

1. Publikimi në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të

organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në hartimin e projektvendimit kanë kontribuar: Drejtoria e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Drejtoria Juridike, Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me ekspertë të GIZ, në kuadër të projektit të BE-së për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër.

Projektakti i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe AKSHI-t.

Nuk rezulton të kenë marrë pjesë palë të tjera interesi jo-qeveritare (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë) në procesin e hartimit dhe konsultimit publik të projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte, si dhe formularin e autorizimit” ka regjistruar 288 shikime dhe 0 komente, në RENJKP.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e intresuara	Vendimi	Justifikimi
-	-	-	-	-